

Çfarë është raporti shkollor?

Në fund të vitit shkollor nxënësit marrin dëftesa. Normalisht dëftesat përmbajnë nota. Por në klasën e parë dhe të dytë Nuk ka nota. Prandaj nxënësit marrin një raport me shkrim nga mësuesi i tyre kujdestar.

Raporti shkollor përshkruan tre fusha:

- sjelljen,
- të punuarit dhe
- të mësuarit e fëmijës.

Sjellja

Si është sjellja përkundrejt mësuesve?
Si është sjellja përkundrejt shokëve të klasës?
Si i trajton fëmija materialet e shkollës?
A është fëmija i kujdesshëm dhe ndihmues?
A është fëmija miqësor dhe i sjellshëm?

Të punuarit

A ka fëmija rezistencë?
A është i vëmendshëm, a i jep rëndësinë e duhur gjërave?
A punon fëmija në mënyrë të pavarur?

Të mësuarit

Çfarë ka mësuar tashmë fëmija?
A mëson fëmija më kënaqësi, shpejtë dhe lehtë?

Në raportin shkollor prindërit mund të lexojnë, se si sillen fëmija në shkollë dhe çfarë zhvillimi ka bërë?
Nëse gjykimet nuk janë të kuptueshme, prindërit mund të kërkojnë një bisedë me mësuesin.

